



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ac.nr.101/18**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Rafet Haxhaj e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L.N., L.2 dhe E.N. – të mitur të cilët i përfaqëson përfaqësuesja e tyre ligjore, këtu paditësja e parë L.N., si dhe paditësit I.N., N.N. dhe Z.N., që të gjithë nga fshati ... komuna e Gjilanit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av.M.M. nga Gjilani, kundër të paditurve B.A. nga Gjilani, tani në adresë të panjohur jashtë Kosove, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm i tij av.A.T. nga Gjilani dhe të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga L.R., zyrtare ligjore pranë të paditësve në fjalë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësve si dhe ankesës së të paditurit të parë, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.272/2005, të datës 22.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.03.2021, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurit të parë B.A. nga Gjilani, e parashtruar përmes përfaqësuesit të përkohshëm të tij av.A.T. nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.272/2005, i datës 22.09.2017, **VËRTETOHET**, përveç kamatës së gjykuar për të gjitha shumat e aprovuara, e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet si në vijim:

- Për pikën **I** të aktgjykimit, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, të cilën e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga data 19.04.2017, e deri në pagesën definitive;

- Për pikën **II** të aktgjykimit, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, të cilën e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga 22.09.2017, e deri në pagesën definitive;

- Për pikën **III** të aktgjykimit, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, të cilën e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga 22.09.2017, e deri në pagesën definitive;

- Për pikën V të aktgjykimit, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, të cilën e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga 22.09.2017, e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 15 ditëve, nën kërcënim të përmbarimit.

**II. REFUZHET** si tërësisht e pa bazuar ankesa e paditësve, e parashtruar kundër aktgjykimit të të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.272/2005, të datës 22.09.2017.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.272/2005, të datës 22.09.2017, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar me ligj kërkesëpadinë e paditësve I.N. N.N. dhe Z.N., që të gjithë nga fshati ... Komuna e Gjilanit e ushtruar kundër të paditurit B.A. nga fshati ... Komuna e Gjilanit, për shkak se me datën 05.11.1999, në aksin rrugor Gjilan - Ferizaj, përballë kompanisë “Bejta Komerc”, i padituri B.A., duke mos i’u përmbajtur dispozitave të komunikacionit ka bërë tejkalim të shpejtësisë me automjetin e tij të markës “Opell Kadet”, me ç’rast ka goditur automjetin e udhëtarëve të markës “Mazda 626”, të cilën e drejtonte i dëmtuari, tani i ndjeri M.N., ku si pasojë e këtij aksidenti lëndime të rënda trupore kanë pësuar të dëmtuarit M.N., tani i ndjerë, I.N. N.N. dhe Z.N., ashtu që gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurin B.A. nga fshati ..., komuna e Gjilanit që paditësve t’ia kompensoje dëmin material dhe jo material si në vijim: Me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit paditësit I.N. nga ... komuna e Gjilanit, t’ia kompensoj dëmin material në emër të makinës së dëmtuar të markës “Mazda 626”, shumën prej 1,419.28 euro, me kamatë bankare ashtu siç kanë paguar institucionet financiare në Kosovë për periudhën kohore nga data 05.11.1999, e deri me 01.01.2013, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë, kurse pas datës 01.01.2013 e deri në pagesën definitive me kamatë ligjore prej 8% në vit, në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Pika II e aktgjykimit për paditësin I.N. dëmin jo material edhe atë: për dhimbjen e fizike shumën prej 3,000.00 euro, për friken e përjetuar shumën prej 3,000.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë në shkallën prej 27.5% shumën prej 6,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 22.09.2017, si datë e marrjes së këtij vendimi, e deri në pagesën definitive, e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm përkatësisht, për paditësin I.N. në emër të dëmit material dhe jo material, gjithsejtë shumën prej 13.419.28 euro. Me pikën II a) të aktgjykimit, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit I.N. të ushtruar ndaj të paditurit B.A., me të cilin ka kërkuar që të detyrohet i padituri në fjalë që paditësit t’ia kompensoj dëmin material edhe atë për ndihmën e personit të tretë shumën prej 250 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 250 euro dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - psikik për 3 vite me rradhë nga dy herë në vit me qëndrim në institucione klimatiko - rehabilitues prej 15 ditësh shumën prej 4,950.00 euro. Me pikën II b) të aktgjykimit, ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit I.N. në shumën prej 19.000 euro të kërkuar më shumë se shuma e gjykuar në emër të

dëmit jo material dhe atë për dhimbjet fizike friken e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor. Me pikën III të aktgjykimit e ka detyruar të paditurin B.A. nga fshati ..., që paditësit N.N. t'ia kompensoje dëmin jo material edhe atë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3.000.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000.00 euro, në emër të shëmtimit shumën prej 1.500.00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 31.25%, shumën prej 7,500.00 euro, duke filluar nga data 22.09.2017, si datë e marrjes së këtij vendimi e deri në pagesën definitive e gjithë këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Me pikën IV të aktgjykimit ka vendosur që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit N.N. për kompensimin e dëmit material edhe atë: në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 500.00 euro, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 1,260.00 euro, në emër të shkatërrimit të gardërobës përkatësisht veshmbathjes shumën prej 350.00 euro, në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 1000.00 euro, në emër të rehabilitimit fiziatriko - psikiatrik për tre vite me radhë nga 2 x në vit me qëndrim në institucione përkatës prej 15 ditësh shumën prej 4,950.00 euro. Me pikën IV a, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit N.N. për kompensimin e dëmit jo material në lartësi prej 28.500.00 euro të kërkuar me shumë se shuma e gjykuar, në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike të përjetuara, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor. Me pikën V të aktgjykimit, e ka detyruar të paditurin e parë që paditëses Z.N. nga fshati ... komuna e Gjilanit t'ia kompensojë dëmin jo material edhe atë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,500.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2,500.00 euro dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 10 % shumën prej 1,500.00 euro, me kamatë prej 8 % në vit, duke filluar nga data 22.09.2017, si datë e marrjes së këtij vendimi, e deri në pagesën definitive, e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, përkatësisht në shumën prej 6,500.00 euro. Me pikën VI të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses Z.N. në lartësi prej 9.500.00 euro, të kërkuar më shumë se shuma e gjykuar edhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike, friken e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Me pikën VI.a) të aktgjykimit, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses Z.N. për kompensimin e dëmit material edhe atë në emër të shkatërrimit të gardërobës veshmbathjes shumën prej 350.00 euro, në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 250.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 250.00 euro edhe në emër të rehabilitimit fiziatriko - psikik prej 1,500.00 euro. Me pikën VII të aktgjykimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit material të paditëses L.N. dhe paditësve të mitur L.2 N. e E. N., të cilët i përfaqëson përfaqësuesja ligjore - nëna e tyre, të ushtruar ndaj të paditurit B.A. nga fshati ..., komuna e Gjilanit, e kërkuar në emër të shkatërrimit të veshmbathjes së të ndjerit N. N., në shumën prej 350.00 euro dhe për ushqim të përforcuar në shumën prej 250.00 euro. Me pikën VIII të aktgjykimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve L.N., fëmijëve të mitur L.2 dhe E. që të dy N., paditësve tjerë I.N. dhe Z.N. të gjithë nga fshati ..., komuna e Gjilanit, të ushtruar ndaj paditurës BKS më seli në Prishtinë, me të cilën paditësit kane kërkuar edhe nga e njëjta që në mënyrë solidare t'ia kompensojë atyre dëmin material dhe jo material të kërkuar si në pikat e lartcekura të dispozitivit të aktgjykimit për pasojat e pësuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 05.11.1999, në aksin rrugor Gjilan - Ferizaj përballë

kompanisë “B...” për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv të të paditurës së dytë BKS me seli në Prishtinë. Me pikën e fundit IX të aktgjykimit, e ka detyruar të paditurin B.A. nga fshati Cerrnicë, komuna e Gjilanit që paditësve t’i paguaj shpenzimet gjyqësore të domosdoshme në lartësi prej 1,418.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe të aprovohet padia e paditësve në tërësi si e bazuar dhe të obligohen të paditurit që ta kompensojnë dëmin material dhe jo material të kërkuar sikurse në propozim të ankesës, ose që lënda të kthehet në rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka përfaqësuar edhe përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të parë B.A. nga Gjilani dhe atë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aprovohet ankesa e të paditurit në fjalë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe të refuzohet si e pabazuar padia e paditësve, si dhe që të aprovohet ankesa e të paditurit të parë B.A., e ushtruar nga përfaqësuesi i tij i përkohshëm avokat A.T. nga Gjilani ndaj vendimit për shpenzimet procedurale dhe të detyrohen paditësit që t’i bartin shpenzimet procedurale në vlerë prej 3,640.00 euro për av.A.T., në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm të tij.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve ankimore të palëve ankuese lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësve, është **e pabazuar;**
- ankesa e të paditurit të parë B.A. nga Gjilani, e parashtruar përmes përfaqësuesit të përkohshëm të tij av.A.T. nga Gjilani, është **e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datën 06.05.2005, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurit të parë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi. Në ndërkohë, padia e paditësve është zgjeruar edhe në raport me të paditurën e dytë BKS me seli në Prishtinë, ndërsa që përgjatë zhvillimit të procedurës ka vdekur paditësi M.N., ish nga fshati Cerrnicë komuna e Gjilanit, ashtu që pas ndërprerjes së procedurës, e njëjta ka vazhduar me tani këtu paditësit. Meqenëse përgjatë zhvillimit të procedurës, i padituri i parë B.A. nga Gjilani, është larguar nga Kosova në adresë të panjohur, gjykata e shkallës së parë me vendim të veçantë, të njëjtit ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve të regjionit të Gjilanit, përkatësisht avokatin A.T. nga Gjilani.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së shqyritimit kryesor dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.272/2005, të datës 22.09.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktgjykimit, ndër të tjera, është theksuar se në rastin konkret aksidenti në fjalë ka ndodhur me datën 05.11.1999, në aksin rrugor Ferizaj – Gjilan, përballë kompanisë “B...”, me ç’rast i padituri i parë B.A. nga Gjilani me automjetin e tij të markës “Opel Kadet”, e ka goditur automjetin e markës “Mazda 626”, të cilin e drejtonte tani i ndjeri M.N., e që si pasojë e këtij aksidenti, lëndime të rënda kanë pësuar edhe paditësit e tjerë të lartcekur. Tutje është theksuar se nuk është kontestues fakti se fajtor për shkaktimin e aksidentit në fjalë ka qenë ngasësi i automjetit “Opel Kadet”, pasi që ky fakt përpos raportit të aksidentit të përpiluar nga ana e pjesëtarëve të KFOR në gjuhën angleze, me shifren MPR-0897-99G, i datës 05.11.1999, po ashtu është konfirmuar edhe nga aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Gjilan P.nr.125/12, i datës 08.04.2003, si dhe ai i Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.149/2013, sipas të cilëve i padituri i parë B.A. nga Gjilani, është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënimin sikurse në këto aktgjykime. Po ashtu është theksuar se në rastin konkret, nuk ka qenë kontestues as fakti se si pasojë e aksidentit në fjalë, lëndime të rënda trupore kanë pësuar paditësit I.N. N.N. dhe Z.N., fakt ky i konfirmuar edhe nga ekspertiza e ekspertëve mjeko ligjor të caktuar për këtë çështje në përbërje prej dr.N.H. – mjekësia ligjore, dr.F.M. ortoped, dr.S.D. – ortoped, si dhe dr.S.R. – kirurg maksilofacial. Në bazë të dokumentit doganor DUD nr.8469, të datës 16.10.1999, gjykata e shkallës së parë ka vëretuar se automjeti i markës “Mazda 626”, ka qenë pronë e të paditurit të parë. Gjykata e shkallës së parë tutje ka theksuar se duke marrë për bazë kohën e ndodhjes së aksidentit 05.11.1999, në atë kohë për shkak të rrethanave të pasluftës, nuk ka pasur të formuara kompani të sigurimeve, për çka shkaktari i aksidentit nuk ka poseduar sigurim të automjetit të tij për dëmin në raport me personat e tretë, andaj edhe përgjegjësia për këtë dëm të shkaktuar bie mbi të. Gjykata në fjalë ka shtuar se e paditura e dytë BKS me seli në Prishtinë, përkatësisht ish FKG me seli në Prishtinë, është themeluar në vitin 2002, ashtu që e njëjta nuk mund të mbajë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara para themelimit të saj për automjetet të cilat nuk janë të siguruara, për çka edhe kërkespadija e paditësve në raport me të paditurën BKS me seli në Prishtinë, është refuzuar si e pabazuar, për shkak se kësaj të fundit i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore. Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenet 178, 185, 186, 189, 190, 195 dhe 200 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD) të vitit 1978, kurse sa i përket kamatës, gjykata në fjalë është bazuar në nenin 382 të LMD së ri të vitit 2012. Në raport me shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 452.1 të LPK.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, i kuptueshëm, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e tij duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket pasojave që kanë pësuar paditësit për shkak të aksidentit të datës 05.11.1999. Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertëve mjeko ligjor dr.N.H. – mjeksi ligjor, dr.F.M. ortoped, dr.S.D. – ortoped, si dhe dr.S.R. – kirurg maksilofacial, pastaj ekspertiza e ekspertit të makinerisë ing.S.Z., si dhe ajo e komunikacionit rrugor Besim Ibrahim, por edhe provat e tjera të administruara, e të cilat kjo gjykatë nuk e sheh të arsyeshme që t'i përsërisë edhe një herë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Me nenin 154 të LMD së zbatuar për këtë rast (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.29/1978), parashihet se *“kush i shkakton tje. dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo – juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesat e aprovuara në shumën sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe përgjegjësini e të paditurit në rastin në fjalë dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve - këtu paditësve, satisfaksion që ata me këto mjete t'i riparojnë deri në një masë nevojat e tyre materiale, që në fakt nuk përfaqëson edhe kompensimin absolut të dëmit. Për këtë arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Për kamatën Gjykata e Apelit ka vendosur në pajtim me dispozitat e nenit 277 të LMD së vitit 1978, i cili zbatohet për këtë rast, si dhe qendrimin e e fundit të Gjykatës

Supreme në lidhje me llogaritjen e kamatës, ashtu që e njëjta për shumat e aprovuara është gjykuar sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, e cila paguhet nga bankat komerciale të Kosovës, në ndërkohë që e njëjta, duke marrë për bazë precizimin e fundit të kërkespadi së paditësve të datës 31.05.2017 (dhe kërkesën e parashtruar në të njëjtën edhe për llogaritjen e kamatës), për dëmin material është llogaritur nga data 19.04.2017 (kur është përpiluar ekspertiza), e deri në pagesën definitive, kurse për dëmin material, kamata është llogaritur prej datës 22.09.2017 (kur është nxjerr aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë), e deri në pagesën definitive. Për këtë arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452.1 LPK. Për këtë arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar në tërësi ankesën e paditësve, pasi që duke marrë për bazë të lartcekurat, gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, shkallën e lëndimeve të pësuar të paditësve, si dhe vetë natyrën e të mirave të privuara nga ata, e në përputhje edhe me rrethanat e vendit, si dhe të vetë ndodhjes së aksidentit, shumat përtej shumave të aprovuara sikurse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk do të ishin në pajtim me shkallën e të mirës së privuar, e as me praktikën gjyqësore të vendit e cila ekziston për rastet e tilla. Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së dytë gjeti se ankesa e tyre ka qenë e pa argumentuar dhe e pabazaur për të vendosur ndryshe nga sa u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), në lidhje me nenin 200 të LPK, ankesat e palëve ndërgjyqësve u refuzuan si të pabazuara dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.101/18, me datën 10.03.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**